

EKSTREMIZMI DHE PLATFORMAT PËR RADIKALIZIM ONLINE NË KOSOVË

Autor
Skender Perteshi



PREVENT

INSTITUTI PËR SIGURI DHE REZILIENCË

Ekstremizmi dhe platformat për radikalizim online në Kosovë

Autor: Skender Perteshi

Asistente e hulumtimit: Besarta Zekaj

Radaktimi dhe dizajni: Instituti PREVENT

Mendimet, analizat dhe të dhënat e paraqitura në këtë raport janë vetëm ato të autorit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet ose qëndrimet e institutit ose partnerëve të tij. Ky raport është menduar vetëm për qëllime informative dhe nuk duhet të interpretohet se përfaqëson motivet, politikat ose objektivat kërkimore të ndonjë prej organizatave ose individëve brenda institutit

Prishtinë, Dhjetor 2024.

Përmbajtja

Shkurtesat	3
Hyrje	4
1. Shtrirja e internetit dhe platformave sociale të komunikimit në Kosovë	5
2. Platformat sociale dhe radikalizmi online.....	6
3. Platformat sociale më të përdorura për përhapjen e radikalizmit dhe ekstremizmit.....	7
3.1 Facebook	7
3.2 Telegram	8
3.3. Instagram	12
3.4. You Tube.....	13
3.5. Tik Tok.....	14
4. Sfidat e medieve për parandalimin e ekstremizmit online	15
5. Narrativat e radikalizmit që përhapen në platformat sociale të komunikimit.....	16
5.1. Interpretimi dhe shtrembërimi i argumenteve religjioze ..	16
5.2. Ulja e besimit në institucionet e shtetit sekular.....	16
5.3. Retorika anti-perëndimore	17
5.4. Jeruzalemi apo Kudsi	18
5.5 Gjuha e urrejtjes ndaj identiteteve fetare në Kosovë.....	18
5.6. Uniteti i Myslimanëve dhe “zbehja e xhihadit”.....	19
5.7. Ndryshimet e dinamikës së fuqisë në Lindje të Mesme.....	20
5.8. ‘Vuajtjet e serbëve në Kosovë’	21
Përfundimet.....	23
Të gjeturat	25

Lista e Shkurtesave

Brigadat e Martirëve - Krahë Ushtarak i organizatës ekstremiste HAMAS.

BE - Bashkimi Evropian

EULEX - Misioni Evropian për Sundimin e Ligjit

HAMAS - Lëvizja e Rezistencës Islamike

Hezbollah - Partia e Zotit; Oranizate ekstremiste islamiste që vepron në Liban dhe mbështetet nga Siria e Irani.

ISIS - Shteti Islamik

KFOR - Forca për Kosovën; Misioni i Natos në Kosovë

MASHT - Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë

MPB - Ministria e Punëve të Brendshme

PK - Policia e Kosovës

SHBA - Shtetet e Bashkuara të Amerikës



Hyrje

Mediat sociale përdoren gjerësisht në Kosovë, veçanërisht nga të rinjtë që përbëjnë shumicën e popullsisë së vendit. Ky grup demografik është veçanërisht i ndjeshëm ndaj përmbajtjeve që promovojnë gjuhë urrejtjeje dhe elemente ekstremiste, duke i ekspozuar ndaj rrezikut të propagandës radikale dhe ndikimit ekstremist. Kosova ka një nivel të lartë përdorimi të mediave sociale, me 1.61 milion përdorues të internetit deri në janar 2024, që përfaqësojnë 96.6% të popullsisë. Ky numër i madh i përdoruesve të internetit në vend krijon mundësi të shumta për përhapjen e ideve ekstremiste dhe radikale, duke rrezikuar të rinjtë që mund të ndikohen nga këto ideologji.

Individë dhe organizata ekstremiste, që veprojnë në Kosovë dhe rajon, vazhdojnë të shfrytëzojnë platforma elektronike të komunikimit si TikTok, Telegram, Facebook, Instagram, YouTube dhe platforma X, për të përhapur propagandë, gjuhë urrejtjeje dhe materiale që nxisin radikalizëm dhe ekstremizëm të dhunshëm. Këto platforma ofrojnë mundësi të mëdha për të organizuar dhe mobilizuar individë, duke i ekspozuar ata ndaj ideologjive që nxisin dhunë, pasiguri apo polarizim shoqëror.

Pavarësisht përpjekjeve të mëdha nga institucionet shtetërore dhe shoqëria civile për të parandaluar ekstremizmin, sfida kryesore ende mbetet parandalimi i përhapjes së ekstremizmit dhe radikalizmit përmes platformave elektronike të komunikimit apo mediave online, duke e bërë të vështirë kontrollimin e përmbajtjeve të dëmshme dhe influencës që ato mund të kenë tek individët më të rinj të cënueshëm.

Një shqetësim në rritje mbetet përhapja e gjuhës së urrejtjes, diskriminimit dhe ndasive fetare dhe atyre me bazë etnike, që bëhen të zakonshme në platformat sociale, duke polarizuar shoqërinë dhe krijuar një ambient të përshtatshëm për rritjen e ekstremizmit të dhunshëm në vend. Edhe pse viteve të fundit radikalizmi online nuk ka ndikuar shumë në rekrutimin e kosovarëve që t'u bashkohen konflikteve të të huaja, ekstremizmi online po krijon një mjedis të përshtatshëm për përhapjen e ideologjive radikale dhe intensifikimin e polarizimit në shoqëri. Diskutimet dhe përmbajtjet që përhapen në platformat sociale mund të nxisin individë të dyshimtë të veprojnë në mënyra të dhunshme, duke destabilizuar rendin social dhe duke kontribuar në tensione dhe ndasi të thella shoqërore.

Grupet ekstremiste, si ato religjioze dhe etno-nacionaliste, kanë humbur pjesën më të madhe të ndikimit në platformat sociale të hapura si Facebook dhe YouTube, ku dikur kishin mundësi të organizonin dhe rekrutonin ndjekës. Aktualisht, këto grupe janë të pranishme kryesisht në platforma të enkriptuara si Telegram dhe TikTok, të cilat ofrojnë anonimitet dhe mundësojnë shpërndarjen

përmbajtjeve radikale në mënyrë më të fshehtë. Këto platforma janë gjithashtu më të përshtatshme për grupet që përhapin ideologji ekstremiste, sepse ato mund të mbështesin materiale vizuale si video dhe meme që janë më tërheqëse për audiencën më të re. Platforma të tilla përdoren për të shtrirë ndikimin e grupeve dhe për të përhapur ideologjitë e tyre tek të rinjtë, kryesisht në moshat 16-20 vjeç, një grup demografik që është i hapur ndaj ndikimeve të jashtme dhe i prirur për të kërkuar një kuptim më të thellë të identitetit shoqëror të tij fetar dhe kombëtar.

Ky hulumtim synon të ofrojë një analizë të thelluar të përhapjes së ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit përmes përdorimit të platformave sociale të komunikimit, me fokus në rrezikun që këto platforma paraqesin për shoqërinë kosovare. Analiza është e orientuar drejt vlerësimit të kërcënimeve që vijnë nga ekstremizmi fetar dhe etno-nacionalist përmes platformave sociale të komunikimit, duke identifikuar narrativat dhe audiencat e synuara nga grupet ekstremiste.

Pjesa e parë e analizës trajton kontekstin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit në Kosovë, duke e lidhur këtë fenomen me përdorimin e mediave sociale. Pjesa e dytë përshkruan platforma sociale si TikTok dhe Telegram, që përdoren nga këto grupe për të shpërndarë ideologjitë e tyre radikale. Pjesa e fundit e analizës ofron një pasqyrë të përgjithshme të ekstremizmit online dhe rreziqeve që ai sjell për shoqërinë, si dhe narrativave që grupet ekstremiste online përdoriun për përhapjen e ekstremizmit të dhunshëm, duke theksuar ndikimin që ai mund të ketë tek të rinjtë dhe polarizimin që mund të krijojë në shoqërinë kosovare.

1. Shtrirja e internetit dhe platformave sociale të komunikimit në Kosovë

Aktualisht në Kosovë janë mbi 1.7 milion përdorues të internetit. Ndër platformat sociale, Facebook-u mbetet aplikacioni më i popullarizuar, me një shtrirje prej 855.9 mijë përdoruesish aktivë, duke mbuluar 53.2% të përdoruesve total të internetit në Kosovë. Facebook vazhdon të jetë ndër burimet kryesore të informacionit dhe, në të kaluarën, veçanërisht gjatë viteve 2011-2018, ka shërbyer si një nga kanalet kryesore për përhapjen e elementeve të ekstremizmit dhe radikalizmit në Kosovë dhe rajon. Përafërsisht 62% e popullatës së Kosovës mbi moshën 13 vjeç janë përdorues të rregullt të Facebook-ut, çka tregon shtrirjen e lartë të kësaj platforme në vend.¹

Instagrami është platforma e dytë më e përdorur, me mbi 603,000 përdorues, që përbën 36.2% të popullsisë aktive të internetit dhe përdoruesve të rrjeteve sociale.

1. Për më shumë shih artikullin e Kosovo fact: "Shtrirja e Internetit në Kosovë"
Qasur në tetor 2024: <https://kosovofacts.com/shtrirja-e-internetit-ne-kosove/>

Grup moshat më të reja, sidomos ato midis 13 dhe 24 vjeç, janë më aktive në platforma si Instagram dhe TikTok, duke i bërë të rinjtë më të ekspozuar dhe të ndjeshëm ndaj ndikimeve në internet, përfshirë mesazhe apo përmbajtje ekstremiste, gjuhë urrejtjeje dhe bullizëm.²

Shtrirja e gjerë e internetit në Kosovë, si dhe përdorimi i madh i platformave sociale, sidomos nga popullata e re midis moshave 18 dhe 34 vjeç, është tregues i një niveli të lartë të cenueshmërisë që kjo grup moshë mund të ketë ndaj përmbajtjeve të dëmshme, përfshirë gjuhën e urrejtjes dhe elementet radikale që janë të pranishme në internet dhe në rrjetet sociale.

Duke pasur parasysh numrin e madh të përdoruesve të telefonave mobil në Kosovë, afërsisht 1.9 milion në total, një shifër që tejkalon numrin e popullsisë, kjo ofron mundësi për rritje të qasjes së qytetarëve në platformat sociale, duke rritur edhe rrezikun e ekspozimit ndaj përmbajtjeve me prirje radikale apo ekstremiste. Mediat sociale janë tashmë ndër faktorët më të rëndësishëm në formësimin e opinionit publik dhe politik mes të rinjve në Kosovë, të cilët influencohen gjithashtu nga mediat tradicionale si TV dhe portalet online, duke dëshmuar ndikimin e fuqishëm që mediat kanë si në përhapjen, ashtu edhe në parandalimin e ekstremizmit online.

2. Platformat sociale dhe radikalizmi online

Radikalizimi përmes mediave sociale është një shqetësim në rritje, veçanërisht në rajonet shqipfolëse si Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut, ku narrativat ekstremiste dhe përpjekjet për rekrutim janë intensifikuar vitet e fundit.³

Platforma sociale si Telegram, YouTube, Facebook, Instagram, X dhe platforma tjera, kanë luajtur një rol të rëndësishëm në përhapjen e këtyre ideologjive, me mbi 1000 qytetarë të rajonit të Ballkanit të radikalizuar dhe përfshirë në konflikte të huaja në Siri dhe Irak.⁴

Sot, platforma të tilla si Telegram, TikTok, Facebook dhe Instagram përdoren nga grupe ekstremiste për të përhapur ideologji, gjuhë të urrejtjes dhe elemente të radikalizmit religjioz dhe nacionalist. Këto grupe shfrytëzojnë fuqinë e mediave sociale për të ndikuar dhe për të rekrutuar ndjekës të rinj, duke përdorur mjetet e komunikimit në këto platforma për të përhapur mesazhe destabilizuese dhe për të përforcuar narrativat e tyre.⁵

2. Po aty.

3. Intervistë me një P.A; ekspert i çështjeve të sigurisë. Tetor 2024, Prishtinë

4. "Offline and Online (De)radicalization: An Overview of the Case of Kosovo"; Kosovar Centre for Security Studies (KCSS). I qasshëm këtu: https://www.pave-project.eu/publications/PAVE_870769_D5.1_publication_layout.pdf

5. Po aty.

3. Platformat sociale më të përdorura për përhapjen e radikalizmit dhe terrorizmit

3.1 FACEBOOK

Facebook mbetet një platformë dominuese për shpërndarjen e përmbajtjeve dhe dezinformatave që nxisin gjuhën e urrejtjes dhe radikalizmin. Me një bazë globale prej mbi 3 miliardë përdoruesish, kjo platformë është shumë atraktive për grupet radikale dhe terroriste që përhapin materiale ekstremiste. Në Kosovë, Facebook vazhdon të jetë platforma kryesore ku ndjekësit bien shpesh pre e lajmeve të rreme dhe dezinformimit. Prania e llogarive të rreme dhe përmbajtjes së paverifikuar e përkeqëson më tej këtë problem, duke i lejuar individë të ndryshëm të përhapin elemente të radikalizmit në masë.

Gjatë periudhës 2012-2019, organizatat ekstremiste fetare dhe individë që e shpallnin veten si udhëheqës shpirtërorë organizonin thirrje publike⁶ për t'u bashkuar me grupe terroriste si "ISIS" dhe "Al Fateh al Sham," duke shpërndarë ideologji të terrorizmit fetar.⁷ Megjithatë, kjo praktikë ka ndryshuar ndjeshëm që nga viti 2020, pas arrestimeve dhe dënimeve të individëve dhe grupeve që përhapnin ekstremizëm online, përfshirë përmes Facebook-ut. Këto masa kufizuese kanë detyruar grupet ekstremiste të ndryshojnë mënyrën e tyre të veprimit, duke orientuar aktivitetet drejt platformave të mbyllura dhe të enkriptuara si Telegram.⁸

Kompanitë dhe platformat online, si Facebook dhe YouTube, kanë luajtur një rol të rëndësishëm në largimin e materialeve dhe subjekteve që përhapin gjuhë urrejtjeje dhe radikalizëm. Çdo ditë, Facebook largon qindra mijëra postime dhe llogari që përmbajnë elemente të ekstremizmit dhe gjuhës së urrejtjes. Megjithatë, mesazhet aktuale në Facebook nuk përfshijnë thirrje të drejtpërdrejta për bashkimin me organizata terroriste, por përhapin mesazhe që krijojnë një ambient të përshtatshëm për përhapjen e elementeve të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Aktualisht, organizatat ekstremiste përdorin Facebook-un për të përhapur imazhe simbolike të xhihadit, religjionit dhe martirizimit të viktimave në konfliktet e vazhdueshme në Lindjen e Mesme dhe për të ndikuar tek ndjenjat e solidaritetit të popullsisë vendase kosovare dhe për të përfituar mendjen dhe zemrën e qytetarëve të Kosovës.⁹

Lufta mes Ukrainës dhe Rusisë, konflikti ndërmjet Izraelit dhe Hamasit, si dhe tensionet mes Izraelit dhe Hezbollahut po përdoren si narrative kryesore për të përhapur gjuhën e urrejtjes dhe anti-semitizmin në Facebook.

6. Po aty.

7. Po aty.

8. Intervistë me një P.A, ekspert i çështjeve të sigurisë. Tetor 2024, Prishtinë

9. Po aty,

Videot e vrasjeve të civilëve palestinezë dhe të sulmeve mbi Gazën janë postuar shpesh nga grupe ekstremiste, të cilët fajësojnë drejtpërdrejt Perëndimin për mbështetjen e Izraelit dhe për sulmet ndaj popullsisë palestineze.¹⁰ Me këtë narrativë, këto grupe përpiqen të përforcojnë imazhin e Perëndimit si “armik të Islamit dhe myslimanëve”, duke tentuar të ulin besimin e qytetarëve të Kosovës ndaj vlerave demokratike dhe perëndimore.¹¹

Një tjetër çështje që diskutohet gjerësisht në Facebook është ndalimi i vajzave me shami për të ndjekur mësimin në shkollat publike, bazuar në një udhëzim administrativ nga Ministria e Arsimit. Kjo ka shërbyer si narrativë që përhap elemente të ekstremizmit online dhe përdoret nga grupet radikale për të nxitë reagime dhe për të rritur mbështetjen e komunitetit, ndaj kauzave të grupeve ekstremiste islamiste, të cilët proklamojnë narrativa se “shteti sekular i Kosovës është kundër islamit si dhe pengon praktikimin e riteve fetare në Kosovë”.¹²

Pas humbjes së fuqisë rekrutuese dhe propaganduese që kishin grupet si ISIS gjatë viteve 2012-2018, kur rekrutoni mijëra luftëtarë të huaj, fokusimi i këtyre organizatave është zhvendosur drejt platformave të mbyllura dhe të enkriptuara si Telegram. Aty, thirrjet për rekrutim dhe bashkim me kauza ekstremiste janë bërë më të zakonshme dhe ndodhin në baza ditore.¹³

3.2. TELEGRAMI

Telegram, një aplikacion mesazhesh i njohur për kanalet dhe grupet e tij të koduara, po përdoret gjerësisht nga individë dhe organizata ekstremiste për përhapjen e formave të ndryshme të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Ekstremistët fetarë dhe etno-nacionalistë i janë drejtuar gjithnjë e më shumë kësaj platforme për shkak të veçorive të saj të komunikimit të sigurt. Aplikacioni u lejon atyre të ndajnë mbështetje për organizatat ekstremiste, narrativat që përdorin, si dhe thirrjet për veprim brenda grupeve të mbyllura, shpesh duke përdorur pseudonime për të ruajtur anonimitetin.

Aktualisht, Telegram është burimi kryesor i përhapjes së ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit online në Kosovë. Organizata dhe individë të lidhur me elemente të ekstremizmit religjioz dhe etno-nacionalist kanë krijuar grupe të mbyllura dhe anonime në telegram, të cilat vazhdojnë të përhapin elemente të ekstremizmit të dhunshëm dhe të bëjnë thirrje për rekrutim dhe sulme ndaj Kosovës, popullatës civile dhe institucioneve të saj, duke u mbështetur në ideologjitë e tyre, si ato të ISIS apo “Mbrotjtjes Civile”.

10. “Si konflikti midis Hamasit dhe Izraelit nxit kërcënimet terroriste në Perëndim” [Tanya Mehra](https://www.icct.nl/publication/how-conflict-between-hamas-and-israel-fuels-terror-threats-west) (2023); ICCT I qasshëm këtu: www.icct.nl/publication/how-conflict-between-hamas-and-israel-fuels-terror-threats-west

11. Intervistë me një P.A, ekspert i çështjeve të sigurisë. Tetor 2024, Prishtinë

12. Të dhëna të marra nga kanalet online të grupeve ekstremiste islamiste në Telegram si: “Xhemati Alban” dhe “Mburoja”. Koha e observimit Korrik-Nëntor 2024.

13. Po aty.

Një shembull se si ekstremistët fetar përhapin elemente të terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm është promovimi i madh që iu bëhet forcave talebane, të cilat kontrollojnë dhe qeverisin në Afganistan, ose siç e quajnë ata “Emiratin e Afganistanit.” Nëpërmjet videove dhe pamjeve të ndryshme, proklamohet se sa e mirë është jeta në “Emiratin Islamik të Afganistanit,” duke e promovuar heroizmin dhe trimërinë e talebanëve si modele që të gjithë muslimanët duhet të ndjekin për të luftuar dhe krijuar një shtet islamik në vendet ku jetojnë ata.¹⁴

Përveç Afganistanit, në kanale të ndryshme në gjuhën shqipe në Telegram, vazhdimisht publikohen pamje të luftimeve dhe sulmeve që ISIS dhe degët e saj realizojnë në vende të ndryshme si Afrika Perëndimore, Somalia, Mozambiku, në Saharë, Republika Demokratike e Kongos dhe vende të tjera, duke sulmuar popullatën civile dhe institucionet shtetërore.¹⁵ Në këto pamje, promovohen narrativa si “lufta, sakrifica dhe përpjekjet e ISIS” për të mbrojtur vlerat islame dhe për të luftuar armiqtë e islamit në botë. Pamje të tilla mund të ndikojnë tek të rinjtë tanë në Kosovë, të cilët mund të jenë të cënueshëm ndaj këtyre mesazheve, veçanërisht duke marrë parasysh numrin e madh të përdoruesve dhe llogarive të platformës Telegram në Kosovë.¹⁶

Lufta ndërmjet Izraelit, Hamasit dhe Hezbollahut është një nga temat që ekstremistët fetar kanë diskutuar më së shumti kohët e fundit në kanale private dhe anonime të komunikimit në Telegram. Publikimi i pamjeve të luftimeve ndërmjet forcave izraelite dhe “Ezzedeen Al-Qassam Brigades,” të njohura si “Brigadat e Martirëve,” i cili është krahu ushtarak i organizatës ekstremiste “Hamas,” si dhe luftimeve ndërmjet “Hezbollahut,” të cilin grupet ekstremiste në gjuhën shqipe e quajnë “Hizbolati,” kanë qenë narrativat kryesore që individët dhe grupet ekstremiste religjioze kanë tentuar të përhapin përmes kësaj platforme.¹⁷ Për më tepër, brigadat “Ezzedeen Al-Qassam” dhe luftimet e saj kundër trupave izraelite janë promovuar për të përfituar mendjet dhe zemrat e të rinjve në Kosovë e rajon, me qëllim të legjitimitimit të kauzave të organizatave ekstremiste si Hamas, Hezbollah apo ISIS.

Ndër faqet kryesore që ekstremistët religjiozë përdorin në Telegram janë: “Xhemati Alban” me mbi 4,300 ndjekës, “Media Islame” me mbi 4,100 ndjekës dhe “Mburoja” me mbi 3,600 ndjekës.¹⁸ Këto faqe, në baza ditore, promovojnë video dhe pamje të luftimeve të “xhihadistëve” kundër forcave të sigurisë në vende si Izraeli, Gaza, Siria, Afganistani, Somalia, Afrika e Veriut dhe vende të tjera ku ISIS ka prani.

14. Të dhëna të marra nga kanalet online të grupeve ekstremiste islamiste në Telegram si: “Xhemati Alban”, “Mburoja”, “Gaza nga Afër”
“Koha e observimit Korrik-Nëntor 2024

15. Po aty.

16. Po aty.

17. Po aty.

18. Po aty.

Faqe dhe kanale të tjera në Telegram, të koduara në gjuhën shqipe dhe që promovojnë elemente të radikalizmit fetar, përfshijnë “Gaza nga Afër” me 700 ndjekës, “Inside Idlib” me mbi 1,100 ndjekës apo “Vilajeti” me rreth 339 ndjekës.¹⁹ Këto janë vetëm disa nga kanalet e shumta aktive të komunikimit në platformën Telegram ku promovohen elemente të ekstremizmit fetar, me synimin për të përhapur ideologjinë ekstremiste dhe për të rritur ndjenjën e solidaritetit të qytetarëve të Kosovës me organizata ekstremiste dhe terroriste që veprojnë në Siri, Irak, Palestinë, Liban, Afganistan dhe vende të tjera në Afrikën e Veriut. Shumica e këtyre llogarive të hapura në Telegram, operojnë me nga dy kanale, njëri që është dinamik dhe aktiv, e plotësohet me të dhëna, ndërsa kanali tjetër shërben si “kanal back up” apo kanal rezerve, që në rast të mbylljes, anëtarët janë të informuar që të kalojnë në kanalin rezerve për të vazhduar komunikimin.

Përveç ekstremizmit fetar, organizata të ndryshme të lidhura me ekstremizmin etno-nacionalist kanë hapur llogari të shumta në platformën Telegram për përhapjen e elementeve të ekstremizmit etno-nacionalist. Këto kanale, kryesisht të hapura nga organizata ekstremiste nga individ të komunitetit serb që jetojnë në Serbi e Kosovë, shpërndajnë propagandë dhe narrativa ekstremiste që synojnë të nxisin armiqësitë ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve, si dhe destabilizimin e Kosovës. Ndër narrativat që organizatat dhe individët ekstremistë serbë postojnë në Telegram përfshihen akuza se “Kosova po ushtron dhunë dhe presion politik ndaj serbëve” dhe se ekzistojnë plane për largimin e serbëve nga pronat e tyre nga ana e shqiptarëve.²⁰

Platforma të ndryshme të komunikimit përditësojnë vazhdimisht lajme, video dhe mesazhe që tentojnë të përhapin narrativa se serbët që jetojnë në Kosovë janë të ekspozuar ndaj dhunës dhe sulmeve nga ana e institucioneve të Kosovës. Sipas këtyre burimeve, serbët paraqiten si të rrezikuar dhe në nevojë për mbështetje, duke përfshirë nxitjen e akteve të dhunshme si mjet reagimi. Ndër kanalet më aktive të ekstremizmit etno-nacionalist në Telegram është “Bunt,” me mbi 86,000 ndjekës.²¹ Kjo platformë e fuqishme informative në telegram, përhap lajme dhe propagandë që synojnë të nxisin urrejtje etnike ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve, duke thelluar armiqësinë mes dy popujve.²² Një tjetër qëllim i saj është minimi i besimit të serbëve ndaj Perëndimit. Platforma promovon narrativën se “Perëndimi ka qenë armik i Serbisë” dhe nxit kundërshtimin ndaj përhapjes së vlerave perëndimore në Serbi dhe rajon. Në vend të kësaj, sugjeron përkrahjen e një ndikimi më të madh nga Rusia dhe Kina, duke i konsideruar këto vende si aleatë të natyrshëm për popullin serb.²³

19. Të dhëna të marra nga kanalet online të grupeve ekstremiste islamiste në Telegram si: “Xhemati Alban”, “Mburoja”, “Gaza nga Afër”, “Vilajeti”, “Inside Idlib”. Koha e observimit Korrik-Nëntor 2024

20. Të dhëna të marra nga kanalet online të grupeve ekstremiste etno-nacionaliste në Telegram si “BUNT”, Koha e observimit Korrik-Nëntor 2024.

21. Po aty.

22. Po aty.

23. Po aty.

Një platformë tjetër e rëndësishme që përhap elemente të ekstremizmit etno-nacionalist është “Бунт је стање духа,” në shqip “Rebelimi është një gjendje shpirtërore,” e cila ka mbi 86,650 ndjekës.²⁴ Kjo platformë vazhdimisht promovon narrativa dhe materiale propaganduese kundër shqiptarëve, grupeve të cënueshme dhe pakicave kombëtare që jetojnë në rajonin e Ballkanit.²⁵ Platforma gjithashtu përhap lajme të rreme dhe dezinformime, duke e përshkruar situatën e serbëve në Kosovë si shumë të vështirë dhe duke akuzuar Policinë e Kosovës për përdorim sistematik të dhunës ndaj tyre. Ky kanal promovon gjithashtu deklarata të politikanëve serbë që nxisin lajme të rreme dhe dezinformim mbi një të ashtuquajtur “plan të Kosovës për spastrim etnik të serbëve në veri.” Kjo narrative është një përpjekje për të rritur tensionet ndëretnike në Kosovë dhe rajon.²⁶ Kjo platformë, ashtu si të tjerat, mbështet aktivitetet e organizatave terroriste si “Mbrotja Civile” dhe “Brigada e Veriut,” të cilat kanë kryer sulme terroriste në Kosovë, duke përdorur armë zjarri dhe bomba, si dhe duke vrarë e plagosur policë të Kosovës, civilë dhe ushtarë të KFOR-it gjatë viteve 2022 deri 2024.

Një tjetër platformë e rëndësishme që promovon materiale dhe narrativa ekstremiste është “СРПСКИ ГЛАСНИК,” e njohur në shqip si “Gazeta Serbe”.²⁷ Kjo platformë përhap narrativën se në Kosovë ekzistojnë celula të grupeve islamike ekstremiste që paraqesin rrezik për popullin serb. Ky kanal në Telegram, duke ndjekur deklarata të politikanëve serbë si Ivica Dačić apo Aleksandar Vulin, përpiket të paraqesë Kosovën dhe Bosnje e Hercegovinën si burime të ekstremizmit islamik.²⁸ Kjo propagandë qëndron në kundërshtim me faktet në terren, të cilat tregojnë se nuk ka celula aktive të ekstremizmit fetar islamik në Kosovë. Për më tepër, institucionet e Kosovës kanë ndërmarrë përpjekje të mëdha kundër individëve që kanë mbështetur ose ju janë bashkuar organizatave terroriste islamike vitet e fundit, duke e vënë theksin tek siguria dhe mbrojtja e rajonit.²⁹

Një faqe tjetër e rëndësishme në Telegram, që promovon elemente të etno-nacionalizmit serb, është “Српски вукови” ose “Ujqërit Serb,” e cila numëron mbi 1,000 ndjekës.³⁰ Kjo platformë shpërndan lajme dhe narrativa për “heronjtë” serbë të vrarë në luftërat e Ballkanit, në Bosnje e Hercegovinë, Kroaci dhe Kosovë gjatë viteve 1992-1999. Sipas narrativës së “Српски вукови,” këta “heronj” shihen si modele që duhen ndjekur për të mbrojtur “botën serbe,” kudo që ajo rrezikohet. Platforma promovon në mënyrë aktive edhe lajme mbi luftimet mes Rusisë dhe Ukrainës, duke glorifikuar individët që iu bashkuan forcave ruse në Ukrainë dhe luftojnë kundër popullit ukrainas.³¹

24. Të dhëna të marra nga kakanali online të grupeve ekstremiste etno-nacionaliste në Telegram. “Бунт је стање духа,” në shqip “Rebelimi është një gjendje shpirtërore”; Koha e observimit Korrik-Nëntor 2024

25. Po aty.

26. Po aty.

27. Të dhëna të marra nga kanalet online të grupeve ekstremiste etno-nacionaliste në Telegram “СРПСКИ ГЛАСНИК,” e njohur në shqip si “Gazeta Serbe”; Koha e observimit Korrik-Nëntor 2024

28. Po aty.

29. Raporti i International Republican Institute (IRI) “Understanding local drivers of violent extremism in Kosovo” (2017).

30. Të dhëna të marra nga kanalet online të grupeve ekstremiste etno-nacionaliste në Telegram Српски вукови” ose “Ujqërit Serb”, Koha e observimit Korrik-Nëntor 2024

31. Po aty.

Një tjetër platformë online e cila promovon mesazhe propaganduese dhe ekstremiste në drejtim të shqiptarëve dhe Kosovës është “Евроазија” apo ndryshe e njohur si “Euroazia” e cila ka më shumë se 9 000 ndjekës.³² Sipas kësaj platforme, serbët në Kosovë janë në rrezik, dhe çdo lejim i shtrirjes së rendit të ligjit nga institucionet Kosovare në komunat veriore të Kosovës, është tradhti për popullin serb dhe atyre që janë vrarë në mbrojtje të kësaj pjese.³³ Pra, kjo platformë në baza ditore promovon lajme dhe materiale që synojnë rritjen e ekstremizmit etno - nacionalist dhe përqarjen etnike mes popullit serb dhe shqiptar.

Këto janë vetëm disa prej më shumë se 90 kanaleve aktive në telegram, në gjuhën serbe, të cilat promovojnë ekstremizëm etno - nacionalist, me qëllim të rritjes së ekstremizmit dhe radikalizmit në vend. Për më shumë, këto kanale të komunikimit në Telegram, në baza ditore postojnë qindra lajme dhe video të luftimeve të forcave ruse në Ukrainë, duke i përkrahur dhe promovuar ato, si dhe duke kërkuar përkrahje për luftën e Rusisë në Ukrainë.

3.3 Instagram

Konfliktet e armatosura globale, si lufta mes Hamasit dhe Izraelit dhe ajo mes Rusisë dhe Ukrainës, kanë krijuar një klimë të favorshme për ekstremistët e motivuar nga ideologji të ndryshme që të përhapin elemente të ndryshme të ekstremizmit religjioz apo atij nacionalist.³⁴ Këta individë dhe grupe po përdorin situatat e krizës ndërkombëtare për të përforcuar mesazhet e tyre radikale dhe për të përhapur gjuhë të urrejtjes dhe antisemitizmit, veçanërisht në platforma të mediave sociale si Instagram.³⁵

Ekstremistët e dhunshëm, përmes përmbajtjeve që glorifikojnë anëtarët e grupeve ekstremiste fetare dhe nacionaliste si heronj dhe martirë që luftojnë në konflikte si Afganistani, Palestina, Ukraina dhe vende të ndryshme afrikane, synojnë të ndërtojnë një narrativë që justifikon aktet e tyre të dhunshme si formë legjitime rezistence ndaj shtypjes nga “armiqët” e tyre. Ekstremistët religjioz dhe ata nacionalist, tentojnë të përhapin mesazhe që synojnë rekrutimin e individëve për kauzat e tyre të dhunshme, fetare apo nacionaliste.³⁶ Kjo qasje është veçanërisht shqetësuese për kontekstin e Ballkanit Perëndimor dhe Kosovës, ku të rinjtë e ekspozuar ndaj këtyre imazheve dhe mesazheve mund të radikalizohen, duke lidhur konfliktet globale me ndjenjat lokale të pakënaqësisë dhe padrejtësisë.³⁷

32. Të dhëna të marra nga kanalet online të grupeve ekstremiste etno-nacionaliste në Telegram “Евроазија” apo ndryshe e njohur si “Euroazia”. Koha e observimit Korrik-Nëntor 2024

33. Po aty

34. “Si konflikti midis Hamasit dhe Izraelit nxit kërcënimet terroriste në Perëndim” Tanya Mehra; ICCT (2023)
I qasshëm këtu: www.icct.nl/publication/how-conflict-between-hamas-and-israel-fuels-terror-threats-west

35. Po aty

36. “Offline and Online (De)radicalization: An Overview of the Case of Kosovo”; KCSS;
I qasshëm këtu: www.paveproject.eu/publications/PAVE_870769_D5.1_publication_layout.pdf

37. Po aty

Rajoni i Ballkanit dhe Kosova janë përballur me sfida të ngjashme nga viti 2012 deri në vitin 2023, kur mbi 1,000 individë nga rajoni dhe Kosova iu bashkuan luftërave të huaja përkrah organizatave ekstremiste në Siri, Irak³⁸ dhe, më vonë, mbi qindra qytetar të tjerë ju bashkuan forcave paramilitare ruse në Ukrainë.³⁹

Në kontekstin e luftës në Palestinë, ekstremistët shfrytëzojnë imazhet e luftimeve në Gaza për të nxitur ndjenja empatie dhe zemërimi të qytetarët e Kosovës, duke e paraqitur çështjen palestineze si një “luftë globale xhihadiste kundër Perëndimit dhe aleatëve të tij”.⁴⁰ Ndërsa në rastin e luftës në Ukrainë, ekstremistët etno-nacionalistë, kryesisht të komunitetit serb, e interpretojnë pushtimin rus të Ukrainës si një përpjekje për të forcuar “botën sllave,” e cila, sipas tyre, është dëmtuar nga Perëndimi, veçanërisht pas rënies së Bashkimit Sovjetik.

Ekstremistet etno nacionalist, që janë kryesisht prezent në Veri të Kosovës dhe në Serbi, promovojnë pamje nga luftimet në Ukrainë si një thirrje për një “rizgjim” të popujve sllavë kundër padrejtësive historike që, sipas tyre, u janë shkaktuar nga fuqitë perëndimore, shqipëtarët dhe kroatët.⁴¹ Mesazhet e tilla të ekstremizmit etno-nacionalist, në të shumtën e rasteve forcohen nga kisha ortodokse serbe dhe ruse, e cila ka qëndruar afër institucioneve shtetërore të Serbisë gjatë çdo konflikti që ka ndodhur në Ballkan, sidomos gjatë luftës në Bosnje dhe Kroaci 1992-1995, si dhe luftës në Kosovë 1998-1999.⁴²

Ndërkohë, konflikti në Ukrainë ka shtuar një dimension tjetër në përhapjen e radikalizmit online, ku grupe ekstremiste, të cilat veprojnë në Serbi dhe Veriun e Kosovës, përfitojnë nga përçarja politike dhe etnike për të ndarë përmbytje që nxit frikën dhe ndasitë mes komuniteteve.

3.4 You Tube

avarësisht përpjekjeve të YouTube për të forcuar monitorimin dhe për të kufizuar përhapjen e radikalizmit dhe ekstremizmit online, rreziku i shpërndarjes së materialeve me elemente të gjuhës së urrejtjes dhe asaj ekstremiste mbetet ende prezent. YouTube vazhdon të jetë një nga platformat kryesore për përhapjen e elementeve të ndryshme të ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit.

38. “Western Balkans Foreign Fighters and Homegrown Jihadis: Trends and Implications”; West Point Counter Terrorism Center; I qasshëm këtu: www.westpoint.edu/western-balkans-foreign-fighters-homegrown-jihadis-trends-implications/

39. Artikull i lajmeve nga Riddle. “Balkan Fighters In Eastern Ukraine: Why are they there?”; I qasshëm këtu: <https://ridl.io/about-riddle-2/>

40. Të dhëna të marra nga kanalet online në telegram të grupeve ekstremiste islamiste si: “Xhemati Alban”, “Mburoja”, “Gaza nga Afër”. Koha e observimit Korrik-Nëntor 2024

41. Të dhëna të marra nga kanalet online të grupeve ekstremiste etno-nacionaliste në Telegram “Евроазија” apo ndryshe e njohur si “Euroazia”. Koha e observimit Korrik-Nëntor 2024

42. Po aty.

Grupet ekstremiste dhe radikale, përfshirë ato të lidhura me ISIS-in dhe grupet etno-nacionaliste aktive në Veri të Kosovës, shpesh postojnë video që justifikojnë dhunën dhe kauzat e tyre, promovojnë radikalizmin fetar islamik dhe ortodoks, dhe bëjnë thirrje për “luftë të shenjtë” për mbështetjen e qëllimeve të tyre.

Organizatat si Hamas, Hezbollah, ISIS dhe degët e tij shpërndajnë çdo ditë pamje dhe video të drejtpërdrejta nga zonat e konfliktit si Siria, Iraku, Afganistani, Palestina, Libani, Ukraina, Somalia dhe vende të tjera ku këto organizata kanë një prani të fortë. Këto grupe postojnë materiale që glorifikojnë luftën dhe dhunën si akte heroike, me synimin për të nxitur shikuesit të mbështesin apo të përfshihen në aktivitete të ekstremizmit. Këto përmbajtje, që përfshijnë video dhe pamje të dhunshme nga luftimet dhe krimet, shpesh shpërndahen edhe në kanale në gjuhën shqipe, me synimin për të rritur përkrahjen mes komunitetit në Kosovë dhe për të fituar simpatinë e individëve për përhapjen e ideologjisë dhe kauzave të tyre.

3.5 TIK TOK

Rreziku i përhapjes së radikalizmit online përmes TikTok-ut po bëhet një shqetësim në rritje në Kosovë, veçanërisht për audiencën e re, që përfshin kryesisht përdorues shumë të rinj. TikTok, me fokusin e tij në përmbajtje të shpejtë dhe vizuale, është tepër tërheqës për përdoruesit e rinj, të cilët janë më të ndjeshëm ndaj mesazheve të forta emocionale.

Vitet e fundit, TikTok është bërë një nga platformat më të përdorura për marketing, biznes, edukim, si dhe për përhapjen e elementeve të ndryshme të ekstremizmit. Në Kosovë, përdoruesit më të mëdhenj të TikTok-ut janë të rinjtë, përfshirë nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme, të cilët mund të bien lehtësisht viktimë e manipulimit nga materiale radikale dhe propagandë që përhap gjuhë urrejtjeje dhe elemente antisemite. Ekstremistët shfrytëzojnë TikTok-un për të shpërndarë përmbajtje në gjuhën shqipe që glorifikon dhunën dhe luftërat në vende si Palestina, Afganistani dhe Ukraina, duke synuar të fitojnë zemrat dhe mendjet e të rinjve nga Kosova për kauzat e tyre ekstremiste.

Këto mesazhe dhe pamje nga zonat e konfliktit paraqiten përmes videove të shkurtra, të dizajnuara për të tërhequr vëmendjen dhe për të ngjallur reagime të forta emocionale. Si rezultat, përdoruesit e rinj, veçanërisht ata më të ndjeshëm, mund të ndihen të tërhequr drejt këtyre ideve dhe të ndikohet nga narrativat ekstremiste. Mungesa e masave efektive të TikTok-ut për limitimin apo parandalimin e përhapjes së materialeve ekstremiste dhe kontrollin e përmbajtjes së dëmshme e rrit potencialin e platformës për përhapjen e radikalizmit dhe gjuhës së urrejtjes.

Ky rrezik kërkon vigjilencë nga ana e platformës dhe ndërhyrje nga institucionet përkatëse për të parandaluar përhapjen e ideve radikale dhe për të mbrojtur përdoruesit e rinj nga ndikimet e dëmshme. Rreziku që platforma TikTok, po sjellë tek të rinjtë nëpër botë, ka bërë që vende të ndryshme të BE-së dhe rajonit të mendojnë edhe mbylljen komplet të kësaj platforme, një ide që duhet të mendohet e konsiderohet seriozisht edhe nga institucionet e Kosovës

4. Sfidat e medieve për parandalimin e ekstremizmit online

Mediat kombëtare në Kosovë shpesh përballen me kapacitete të kufizuara profesionale dhe burime të pamjaftueshme për të parandaluar dhe luftuar ekstremizmin online, lajmet e rreme dhe dezinformimin. Mediat vendore me shtrirje kombëtare dhe lokale, si televizionet kombëtare e lokale, gazetatat dhe portalet online, shpesh nuk kanë burimet e nevojshme për të punësuar gazetarë të specializuar në siguri apo kundër terrorizmit, të cilët do të ishin në gjendje të përgatisnin dhe hulumtonin me saktësi temat e ndërlidhura me sigurinë, terrorizmin dhe radikalizmin.⁴³ Kjo mungesë e gazetarëve të specializuar çon shpesh në raportime jo të sakta, dhe pa dashje përhapin informacione të pa verifikuara, duke e komplikuar më tej përpjekjen për gazetari cilësorë që synon parandalimin e radikalizmit apo ekstremizmit në vend.⁴⁴

Një tjetër sfidë me të cilën përballen mediat në vend është hapësira që ato u japin individëve dhe subjekteve që përhapin lajme të rreme dhe urrejtje fetare apo kombëtare. Disa media në Kosovë, kur trajtojnë tema që lidhen me çështjet kombëtare dhe fetare, në mënyrë të pavetëdijshme dhe të paqellimshme, mbështesin narrativat e grupeve ekstremiste dhe terroriste si ISIS, HAMAS, Mbrojtja Civile dhe Brigadat e Veriut. Duke ftuar në debate persona të pa informuar mbi çështjet e sigurisë dhe radikalizmit, disa media u japin platformë individëve që përdorin këto forume për të sulmuar dhe keq informuar publikun mbi komunitetet fetare dhe kombëtare të vendit, të cilat ndihmojnë apo “legjitimojnë propagandën apo ideologjitë” e organizatave terroriste si ISIS. Kjo qasje kontribuon në normalizimin e gjuhës së urrejtjes, duke rritur polarizimin mes komuniteteve fetare, kombëtare dhe sekulare në vend.⁴⁵

43. Perteshi, Skender; “Rreziqet e reja nga Ekstremizmi i Dhunshëm në Kosovë”; I qasshëm këtu: www.qkss.org/images/uploads/files/violent-extremism-alb_249565.pdf

44. Kraja; Perteshi, Skender; “Doracak i gazetarëve- Parandalimi i Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizmit në Kosovë” I qasshëm këtu: qkss.org/images/uploads/files/Doracaku_Alb.pdf

45. Intervistë me një P.A, ekspert i çështjeve të sigurisë. Tetor 2024, Prishtinë



5. Narrativat e radikalizmit që përhapen në platformat sociale të komunikimit

5.1. Interpretimi dhe shtrembërimi i argumenteve religjioze

Në ditët e sotme, ekstremistët dhe radikalistët islamist po tentojnë të promovojnë një version të shtrembëruar të Islamit, duke u thirrur në “rikthim në bazë” apo në rrënjët e fesë për të zbatuar islmain që, sipas tyre, ‘mbështetet në praktikat e pastra fetare islame’. Me këtë qasje, ekstremistët fetarë synojnë individë të cënueshëm, të cilët lehtë mund të bëhen viktimë të mashtrimit apo manipulimit të tyre dhe gradualisht t’i tërheqin drejt ideologjisë së tyre.⁴⁶

Për më tepër, ekstremistët islamikë, si anëtarët dhe përkrahësit e ISIS, vazhdojnë të shtrembërojnë koncepte dhe narrative fetare si “xhihadi,” “Lufta e Shenjtë,” “Shehid,” “kalifati” dhe koncepte të tjera, të cilat tentojnë t’i lidhin me konfliktet aktuale në botë, si në Palestinë, Siri apo Liban.⁴⁷ Ata e paraqesin luftën në Siri, Palestinë dhe Liban si “xhihad,” duke kërkuar vëmendjen dhe përkushtimin e muslimanëve anembanë botës për të bashkuar forcat me këto kauza, duke i konsideruar si obligim të çdo besimtari dhe praktikuesi që të marrë pjesë në këto konflikte kundër armiqve të islamit. Kjo qasje është veçanërisht shqetësuese pasi shfrytëzon ndjenjat e padrejtësisë dhe tensioneve globale për të rekrutuar individë në radhët e tyre, duke përfshirë të rinjë të cënueshëm nga Kosova dhe rajoni.

5.2. Ulja e besimit në institucionet e shtetit sekular

Një narrativë tjetër dominuese që përdoret nga grupet ekstremiste fetare dhe etno-nacionaliste lidhet me minimin e besimit të qytetarëve në institucionet shtetërore të Kosovës. Ekstremistët fetarë dhe nacionalistë vazhdojnë të shfrytëzojnë ankesat sociale dhe ekonomike, si papunësia, korrupsioni dhe padrejtësitë e perceptuara ndaj komunitetit praktikues mysliman dhe pakicave në Kosovë, për ta portretizuar shtetin si të paligjshëm ose të paafte për të mbrojtur qytetarët e tij.⁴⁸ Ata paraqesin institucionet shtetërore të Kosovës si mekanizma që nuk bëjnë asgjë për të mbrojtur praktikuesit muslimanë në Kosovë, duke e bërë të pamundur krijimin e një ambienti të përshtatshëm për praktikimin e lirive fetare islame në vend.⁴⁹

46. Raporti “Roli i mediave sociale në radikalizimin dhe terrorizmin”; The Program on Extremism at The George Washington University Jacob Ware; I qasshëm këtu: www.extremism.gwu.edu/sites/g/files/zaxdzs5746/files/2023-06/third-generation-final.pdf

47. Intervistë me F.A, njohës i Islamit dhe Radikalizmit. Prishtinë, Nëntor 2024.

48. Të dhëna rreth marra nga kanalet online në telegram të grupeve ekstremiste islamiste si: “Xhemati Alban”, “Mburoja”, “Gaza nga Afër” “Koha e observimit Korrik-Nëntor 2024

49. Po aty.

Një nga argumentet kyçe që ata përdorin është ndalimi që shkollat publike u bëjnë vajzave që bartin shami të ndjekin mësimin në shkollat publike, duke e paraqitur këtë si dëshmi se Kosova është një shtet që punon kundër të drejtave të muslimanëve, pavarësisht faktit se shumica e popullsisë i takon besimit islam.⁵⁰

Shqetësimet e komunitetit praktikues musliman kosovar, si moslejimi i edukimit apo punësimit të grave që bartin shami janë argumente që fuqimisht përdoren nga organizatat terroriste si ISIS, duke e paraqitur shtetin si armik të vlerave islame. Për më tepër, ekstremistët e akuzojnë Kosovën se është rreshtuar në grupin e gabuar të shteteve të Perëndimit, të cilat ata i shohin si armiq të islamit. Kjo qasje rrit ndjenjën e padrejtësisë dhe shfrytëzon ndjenjat e revoltës për të rekrutuar individë në radhët e tyre.⁵¹

5.3 Retorika anti-perëndimore

Retorika anti-perëndimore vazhdon të mbetet një narrativë kyçe e propaganduar nga grupet ekstremiste fetare dhe etno-nacionaliste. Në Kosovë, kjo shpesh merr formën e portretizimit të vendeve dhe institucioneve perëndimore (si NATO, BE dhe SHBA) si ndikime imperialiste ose korruptuese, të cilat kanë projekte madhore për shkatërrimin e vendeve islame dhe atyre të lindjes (sllave).⁵² Grupet ekstremiste fetare dhe etno-nacionaliste pretendojnë se ideologjitë perëndimore, si demokracia, sekularizmi dhe liberalizmi kulturor, janë kërcënime për traditat, fenë dhe identitetin vendas. Kjo retorikë anti-perëndimore është ri-aktualizuar, sidomos pas intensifikimit të luftës ndërmjet Hamasit dhe Izraelit, si dhe konfliktit Rusi-Ukrainë, ku kanë mbetur të vrarë dhjetëra mijëra civilë, ukrainas, palestinezë dhe izraelitë.⁵³

Ekstremistët islamikë që janë mbështetës të ISIS, si dhe ata etno-nacionalistë të organizatave si “Mbrojtja Civile” apo “Brigada e Veriut”, e shohin Perëndimin si armik të përbashkët, duke i fajësuar shtetet perëndimore si arsye kryesore për shkatërrimin e vendeve islame në Lindjen e Mesme, si dhe të vendeve si Serbia dhe Bashkimi Sovjetik, për shkak të politikave dhe planeve të tyre. Kjo retorikë rrit ndjenjat e revoltës dhe polarizimit, duke ushqyer ideologjitë radikale dhe duke kontribuar në radikalizimin e individëve të rinj e të cënueshëm.⁵⁴

50. Të dhëna të marra nga kanalet online në telegram të grupeve ekstremiste islamiste si: “Xhemati Alban”, “Mburoja”, “Gaza nga Afër”. Koha e observimit Korrik-Nëntor 2024

51. Po aty.

52. Të dhëna të marra nga kanalet online në telegram të grupeve ekstremiste islamiste dhe etno nacionaliste si: “Xhemati Alban”, “Mburoja”, “Gaza nga Afër” Европазија” apo ndryshe e njohur si “Euroazia”, “BUNT”. Koha e observimit Korrik-Nëntor 2024

53. Po aty.

54. Po aty.

5.4. Jeruzalemi apo Kudsi

Bombardimi i Gazës dhe vrasja e civilëve palestinez, mbetën një ndër narrativat e fuqishme që grupet ekstremiste përdorin për të përhapur elemente të ekstremizmit islamist online. Shkatërrimi masiv i Gazës, duke përfshirë shkolla, spitale dhe objekte religjioze, ka hapur rrugë që ekstremistët dhe radikalët të prodhojnë materiale radikale dhe ekstremiste me qëllim të përhapjes së ekstremizmit fetar nëpërmjet mediave sociale. Materiale të tilla janë prodhuar edhe në gjuhën shqipe, dhe të cilat janë publikuar në media të ndryshme online si dhe platforma si Facebook, Tiktok, Telegram, Instagram e Youtube. Narrativa e Kudsit luan një rol kyç në ekstremizmin islamist, duke përdorur simbolikën e qytetit të shenjtë për të justifikuar qëllimet ekstremiste. Për grupe të caktuara, Kudsi përfaqëson një simbol të sakrificës për mbrojtjen e Islamit.

Ekstremistët e paraqesin Kudsit si "tokë të shenjtë të uzurpuar nga armiqtë," gjë që ushqen ndjenjat e padrejtësisë dhe përforcon një narrativë konflikti mes Islamit dhe Perëndimit.⁵⁵ Kjo nxitje për "çlirimin e Kudsit," e lidhur me retorikën e xhihadit, shërben për të rekrutuar dhe për të justifikuar veprime të dhunshme si pjesë e një "detyrimi moral" për myslimanët, që e identifikojnë veten me ekstremistët fetar.⁵⁶ Përdorimi i KUDS-it, si narrativë për përhapje të ekstremizmit fetar Islamit ka ndodhur edhe në të kaluarën nga organizata ekstremiste si ISIS, gjatë viteve 2011-2018, narrativë të cilën e kanë përdorur shumë për rekrutimin e luftëtarëve të huaj që të bashkohen ISIS-it. Një narrative e tillë, është ri-aktualizuar sërish pas fillimit të luftës mes Izraelit dhe Hamasit, dhe Kudsi po vazhdon të përdoret si narrative kryesore nga grupet si ISIS, e HAMAS, për të marrë vëmendjen dhe përkrahjen e të rinjve kosovar për kauzën e tyre.

5.5. Gjuha e urrejtjes ndaj identiteteve fetare në Kosovë

Në vitet e fundit, kemi vërejtur një rritje të fyerjeve dhe sulmeve ndaj komunitetit islam praktikues në Kosovë, përfshirë imamët dhe Bashkësinë Islame të Kosovës. Disa lëvizje ose iniciativa të krijuara në Kosovë kanë nisur fushata linçuese dhe fyese ndaj myslimanëve dhe udhëheqësve të tyre. Këto lëvizje si "Levizja e Decanit" të cilat janë grupe formale dhe jo formale, po e paraqesin islamin si "dicka e keqe, të rrezikshme dhe si kërcënim për identitetin kombëtar shqiptar".⁵⁷ Individë nga këto iniciativa kanë deklaruar se Bashkësia Islame e Kosovës ka lidhje me ISIS-in dhe se janë përhapësit kryesorë të ekstremizmit të dhunshëm dhe islamit politik në vend. Një akuzë tjetër e rëndë nga lëvizje ekstreme, si "Levizja e Deçanit", është se mbi 50% e imamëve të BIK janë punonjës të Shërbimit të Sigurisë dhe Inteligjencës së Serbisë (BIA) dhe punojnë kundër interesave të sigurisë së Kosovës, duke u quajtur tradhtarë.⁵⁸

55. Të dhëna të marra nga kanalet online në Telegram të grupeve ekstremiste islamiste si: "Xhemati Alban", "Mburoja", "Gaza nga Afër". Koha e observimit Korrik-Nëntor 2024.

56. Po aty.

57. Për më shumë shih artikullin: "Kush është Levizja e Decanit". I qashtëm këtu <https://klankosova.tv/cocaj-nga-levizja-e-decanit-kemi-pasur-ide-te-formojme-fene-e-shqiptarit-shqiptaria/>

58. Për më shumë shih artikullin e publikuar nga Gazeta Online Bota INFO "Vuvuzelat e BIK"; I qashtëm këtu: <https://www.botasot.info/opinione/2236043/vuvuzelat-e-bashkesise-islame/>

Deklaratat të tilla, të lidhura me gjuhën e urrejtjes, janë të dëmshme për shoqërinë dhe krijojnë një ambient të përshtatshëm për përhapjen e ekstremizmit dhe radikalizmit. Problemi real që sjellin këto lëvizje është hapësira mediale që iu ofrohet individëve nga këto organizata. Kjo qasje dhe kjo fyerje ndaj komunitetit islam praktikues të Kosovës nga ekstremistët nacionalistë, po ndikon në polarizimin e shoqërisë, po ushqen rritjen e ekstremizmit reciprok, qoftë islamist apo nacionalist, si dhe krijon ambient të përshtatshëm për rritjen e polarizimit shoqëror, si dhe pasigurisë në vend.

5.6. Uniteti i Myslimanëve dhe “zbehja e xhihadit”

Aktualisht ekstremistët fetar, janë duke shpërndarë narrativa dhe analiza të cilat pretendojnë se “lufta e madhe” apo lufta e III botërore është afër. Sipas tyre, një ngjarje e tillë duhet ti gjejë ekstremistët fetar dhe etno - nacionalist të përgaditur.⁵⁹ Sipas ekstremistëve fetar nga organizatat si ISIS, apo krahu ushtarak i HAMASI-t në këtë luftë, myslimanët nuk duhet të jenë të përanditur vetëm me njohuritë fetare, por të jenë të pajisur mirë edhe me njohuritë ushtarake dhe luftarake për përdorimin e armëve, sepse janë shumë të rëndësishme drejt triumfit të islamit në këtë luftë të madhe që së shpejti do të vjen.⁶⁰

Për e gjetur interesante në këtë raport është edhe deklarimi i ekstremistëve islamist se aktualisht “përpjekja për xhihad dhe përkrahja e xhihadit nuk është e njëjtë sic ka qenë përgjatë viteve 2012-2019. Pra, sipas tyre një pjesë e “xhihadistëve” që ishin aktiv në vitet 2014-2019, janë vrarë, një pjesë e tyre kanë vdekur për shkaqe të ndryshme natyrore, ndërsa një numër i madh prej tyre kanë ndryshuar mendje, dhe janë larguar nga “Xhihadi”.⁶¹ Sipas tyre “ne u bëjmë thirrje atyre që kanë ndryshuar mendje, dhe kanë braktisur xhihadin, që të kthehen në rrugën e xhihadit, ta mbrojnë dhe përkrahin atë” në të kundërtën është rrezik që “xhihadit do ti bashkohen individ, të rinjë në moshë, që nuk janë praktikues të thellë të islamit, si dhe nuk kanë njohurinë e duhur të Islamit”.⁶² Pra, sipas ISIS-it “tek Allahu, xhihadistët e rinjë dhe të pa përkushtuar ndaj islamit, do të vlerësohen më së shumti, në rrugën për mbrojtjen e islamit”.

59. Të dhëna të marra nga kanalet online në telegram të grupeve ekstremiste islamiste si: “Xhemati Alban”, “Mburoja”, “Gaza nga Afër”
Koha e observimit Korrik-Nëntor 2024.

60. Po aty.

61. Po aty.

62. Po aty.

Bazuar në këto të dhëna dhe diskutimet që po zhvillohen në kanale të mbyllura në telegram, është një tregues që organizatat ekstremiste nuk e kanë luftëtar, fuqinë dhe mbështetjen për të përhapur propaganda dhe rekrutuar luftëtar të huaj, të cilën përkrahje e kanë pasur gjatë viteve 2012-2019.⁶³ Kjo po ndodhë për shkak të intervenimeve të shteteve dhe organizatave jo qeveritare me zbatim të programeve për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, të cilat kanë ulur interesimin e individëve për tu bashkuar me organizatat ekstremiste. Kjo dëshmohet edhe në bisedat e ekstremistëve fetar në telegram të cilët deklarojnë se “një pjesë e madhe e ish anëtarëve të organizatave terroriste, kanë ndërruar mendje” dhe nuk e përkrahin me kauzën dhe qëllimet e ISIS.⁶⁴ Organizatat ekstremiste duket që pritje të mëdha kanë në rekrutim apo përhapje të kauzës ekstremiste tek të rinjtë, kryesisht jo praktikues të rregullt të islamit, dhe të cilët nuk kanë njohuri për islamin. Kjo kategori e të rinjve është shumë e cenueshme, dhe cak i lehtë për tu rekrutuar nga organizatat ekstremiste fetare.⁶⁵ Organizatat si ISIS, një qasje të njëjtë rekrutimi e propaganda e kanë përdorur gjatë luftës në Siri dhe Irak, ku janë rekrutuar mijëra luftëtar të huaj për tu bashkuar me grupe si ISIS, apo Al Fateh al SHAM.

5.7. Ndryshimet e dinamikës së fuqisë në Lindje të Mesme

Siria dhe Iraku vazhdojnë të jenë skenat kryesore të konfliktit në Lindjen e Mesme, ku aktorë rajonalë dhe globalë luajnë një rol vendimtar. Fuqitë si Turqia, Irani, Arabia Saudite, Rusia, Izraeli dhe SHBA-të po ndikojnë në mënyrë aktive dinamikën e konfliktit, duke ndjekur interesa strategjike dhe politike të ndryshme. Një tregues i rëndësishëm i ndryshimit të balancës së fuqisë në rajon është ofensiva e forcave rebele islamike dhe atyre demokratike siriane në rajonet e Idlibit dhe Alepos. Marrja e kontrollit të këtyre zonave nga forcat rebele, të mbështetura nga Turqia, tregon ndikimin në rritje të Ankarasë në konflikt, ndërsa fuqia e Iranit në rajon duket se është dobësuar. Irani, i cili më parë kishte një ndikim të madh përmes mbështetjes së milicive si Hezbollahu dhe Hamas, tani përballlet me kufizime serioze, veçanërisht pas humbjeve të këtyre grupimeve në përballjet me Izraelin.

Në këtë kontekst, rritja e rolit të forcave rebele në Siri dhe lufta e tyre kundër regjimit të Bashar al-Assad mund të kenë ndikime edhe në Kosovë. Kjo lidhet me rrezikun e përfshirjes së qytetarëve nga Kosova në konfliktin civil në Siri, veçanërisht duke pasur parasysh simpatinë që disa prej ish-luftëtarëve kosovarë kanë për grupime si forcat demokratike siriane dhe organizatën Tahrir al-Sham. Këto grupe janë parë me mbështetje nga disa ish-luftëtarë që kanë qenë aktivë në Siri dhe Irak gjatë viteve 2014-2020.

Rezultatet e zgjedhjeve të fundit parlamentare në Irak, të mbajtura në tetor 2024, kanë krijuar një panoramë të re politike në vend. Fitues doli kleriku konservator

63. Po aty.

64. Po aty.

65. Po aty.

fetar Muqtada al-Sadr, një lider i shquar shiit, blloku politik i të cilit, Lëvizja Sadrist, siguroi 73 nga 329 vende në parlament. Zgjedhjet shënuan humbjen e partive politike që kishin gëzuar më parë mbështetje të fuqishme nga Irani, duke treguar një ndryshim të qartë në peizazhin politik irakian. Kjo situatë e re politike në Irak pritet të rrisë pasigurinë dhe paqëndrueshmërinë, duke krijuar një potencial për konflikte të reja në rajon. Përveç aktorëve të brendshëm, ka gjasa që edhe fuqitë rajonale si Arabia Saudite, Irani, Rusia dhe Turqia të angazhohen për të ndikuar në zhvillimet e ardhshme. Paralelisht, paqëndrueshmëria në Siri dhe Irak mund të krijojë hapësira të reja për grupet xhihadiste, të cilat mund të përpiqen të shfrytëzojnë këtë situatë për të avancuar agjendat e tyre përmes sulmeve dhe veprimeve luftarake.

Këto zhvillime në Lindjen e Mesme kanë potencial të ndikojnë drejtpërdrejt edhe në Kosovë dhe në Ballkanin Perëndimor, veçanërisht për shkak të ndjeshmërisë së rajonit ndaj ndikimeve të jashtme dhe mundësisë së përhapjes së ideologjive ekstremiste. Për këtë arsye, Kosova duhet të jetë e përgatitur, duke forcuar masat e saj parandaluese dhe duke intensifikuar bashkëpunimin me partnerët ndërkombëtarë për të përballuar kërcënimet e mundshme që mund të burojnë nga kjo situatë e ndërlikuar.

5.8 ‘Vuajtjet e serbëve në Kosovë’

rganizatave etno-nacionaliste, si “Mbrotja Civile”, Brigada e Veriut” si dhe politikane dhe parti të ndryshme politike serbe, në mënyrë të vazhdueshme janë duke përhapur propagandë dhe lajme të rreme, të cilët postojnë mesazhe propaganduese duke u thirrur në tregime rreth vuajtjeve të popullit serb në Kosovë, nga “dhuna sistematike të ushtruar nga Policia e Kosovës” nën drejtimin e Qeverisë Kurti.⁶⁶

Grupet ekstremiste dhe individë të lidhur me organizata ekstremiste që veprojnë në pjesën Veriore të Kosovës, janë duke tentuar që aksionet policore të Policisë së Kosovës që zbatohen kundër krimit të organizuar po tentojnë ti asociojnë si sulme kundër popullatës civile serbe, si dhe tentim të Qeverisë së Kosovës, për të larguar civilët serb nga Kosova.⁶⁷ Narrativa të tilla, janë duke u ndihmuar mjaftë edhe nga parti politike dhe institucione shtetërore të Serbisë, të cilët në baza ditore publikojnë lajme të rreme, që siç theksojnë ata “dhunës që Policia e Kosovës ushtron ndaj serbëve lokal, apo planeve të Kosovës për spastrim etnik ndaj serbëve”. Narrativa të tilla janë shpërndarë nga media dhe kanale të komunikimit në platformat elektronike si Telegram dhe Facebook, të cilët janë përkrahur dhe kontrolluar nga organizata ekstremiste si “Mbrotja Civile” apo “Brigada e Veriut”

66. Të dhëna të marra nga kanalet online të grupeve ekstremiste etno-nacionaliste në Telegram si “BUNT”; Koha e observimit Korrik-Nëntor 2024

67. Po aty.

të cilët janë përgjegjës për sulmin ku u vra polici i Kosovës Afrim Bunjaku në shtator të vitit 2023, organizimit të protestave të dhunshme në maj 2023, ku u plagosën mbi 92 ushtar të KFOR-it. Për më shumë organizata si “Mbrojtja Civile” dhe “Brigada e Veriut” janë përgjegjës për hedhjen e bombave dhe sulmet me armë ndaj institucioneve të Kosovës në pjesën veriore, si dhe sulmet ndaj KFOR, EULEX, dhe ndaj popullatës civile serbe që ka jetuar në atë pjesë të shtetit.

TË GJETURAT

1. Përdorimi masiv i mediave sociale dhe rreziku për të rinjtë

Në Kosovë, përqindja e lartë e popullsisë që ka qasje në internet (96.6%) dhe përdorimi i platformave si TikTok, Telegram, Facebook, Instagram, dhe YouTube e bën vendin veçanërisht të ndjeshëm ndaj radikalizimit online. Të rinjtë midis moshës 16 dhe 20 vjeç janë demografia më e ekspozuar për shkak të përdorimit të shpeshtë të këtyre platformave dhe mungesës së burimeve për edukim mediatik. Përmbajtjet radikale shpesh përshtaten me interesat e tyre për t'i manipuluar dhe për të nxitur angazhimin.

2. Kalimi i ekstremistëve drejt platformave të sigurta

Masat e marra nga platforma si Facebook dhe YouTube për kufizimin e përmbajtjeve radikale kanë bërë që grupet ekstremiste të kalojnë në platforma të koduara si Telegram dhe aplikacione të ngjashme. Këto platforma ofrojnë një hapësirë të sigurt për komunikim anonim, duke u mundësuar ekstremistëve shpërndarjen e përmbajtjeve ideologjike, planifikimin e aktiviteteve dhe rekrutimin e individëve pa ndonjë rrezik të dukshëm për t'u zbuluar.

3. Konfliktet globale si katalizatorë të ekstremizmit

Konfliktet globale, si lufta midis Rusisë dhe Ukrainës apo konflikti izraelito-palestinez, janë shfrytëzuar nga organizatat ekstremiste për të përhapur narrativat e tyre dhe për të justifikuar aktet e dhunshme. Grupet si Hamas, Mbrojtja Civile, ISIS dhe Hayat Tahrir al-Sham përdorin pamjet e luftës dhe propagandën për të nxitë përkrahje për kauzat e tyre dhe për të rekrutuar individë nga Kosova dhe Ballkani.

4. Narrativat fetare dhe etno-nacionaliste

Ekstremistët përdorin një kombinim të narrativave fetare dhe etno-nacionaliste për të polarizuar komunitetet dhe për të thelluar ndarjet shoqërore. Për shembull, Telegram përdoret për të lidhur konflikte globale, si ato në Palestinë, me narrativat lokale, duke krijuar ndjesi viktimizimi dhe martirizmi që mund të ndikojnë në radikalizimin e individëve.

6. Sfidat në monitorimin dhe kontrollin e radikalizimit online

Kontrolli i përmbajtjeve të dëmshme në mediat sociale është një sfidë e madhe për institucionet në Kosovë. Kornizat ligjore dhe mungesa e koordinimit mes agjencive të sigurisë e bëjnë të vështirë mbikëqyrjen dhe parandalimin e përhapjes së radikalizmit online. Mungesa e bashkëpunimit me platformat ndërkombëtare të mediave sociale dhe kapacitetet e kufizuara për monitorim janë ndër sfidat kryesore.

7. Interpretimi dhe shtrembërimi i argumenteve fetare

Ekstremistët islamikë përdorin një version të shtrembëruar të Islamit duke e paraqitur si “rikthim në bazë” për të rekrutuar individë vulnerabël dhe për të promovuar ideologjinë e tyre. Përdorimi i koncepteve fetare si “xhihadi,” “Lufta e Shenjtë,” dhe “Shehid” është i shfrytëzuar për të justifikuar konfliktet dhe rekrutimin e individëve për luftëra të dhunshme, si në Siri, Palestinë dhe Liban.

8. Minimi i besimit në institucionet shtetërore të Kosovës

Grupet ekstremistë fetarë dhe etno-nacionalistë po përdorin ankesat sociale dhe ekonomike për të portretizuar institucionet shtetërore si të paafta dhe anti-muslimane. Ndalimi i përdorimit të shamisë në shkolla është një argument i përdorur për të përhapur një narrativë që portretizon shtetin si armik të vlerave islame. Ekstremistët akuzojnë Kosovën për rreshtim me shtetet perëndimore si armiq të Islamit, duke përdorur këtë për të rekrutuar individë.

9. Retorika anti-perëndimore

Ekstremistët e përdorin Perëndimin, përfshirë NATO-n dhe SHBA-në, si armiq të Islamit dhe traditave vendase, duke i fajësuar për shkatërrimin e vendeve islame dhe ndikimin imperialist. Konfliktet globale si Lufta mes Hamasit dhe Izraelit dhe Lufta Rusi-Ukrainë janë përdorur për të mbështetur këtë narrativë dhe për të rekrutuar individë për kauza ekstreme.

10. Rritja e përdorimit të Jeruzalemit (Kudsi) si simbol ekstremist

Ekstremistët përdorin bombardimin e Gazës dhe ngjarje të tjera për të krijuar materiale radikale dhe për të mobilizuar ndjenja anti-perëndimore dhe armiqësore ndaj Izraelit. Kudsi është paraqitur si “tokë e shenjtë e uzurpuar” dhe përdoret për të nxitë ndjenja të padrejtësisë dhe për të justifikuar dhunën si një “detyrim moral” për myslimanët.

11. Gjuha e urrejtjes dhe polarizimi në Kosovë

Grupet ekstremistë nacionalistë po përdorin gjuhën e urrejtjes ndaj komunitetit musliman në Kosovë, duke fyer udhëheqësit dhe institucionet fetare islame. Kjo ka krijuar një mjedis që ushqen ekstremizmin dhe radikalizmin reciprok, si dhe kontribuon në polarizimin e shoqërisë.

12. Uniteti i myslimanëve dhe "zbehja e xhihadit"

Ekstremistët po shpërndajnë ideologjinë se një luftë botërore është afër, dhe ata kërkojnë që myslimanët të jenë të përgatitur, jo vetëm në aspektin fetar, por edhe ushtarak. Organizatat si ISIS janë duke përdorur këtë si një mënyrë për të mobilizuar individë të rinj dhe për të rekrutuar luftëtarë të huaj, duke shpërndarë propaganda për xhihadin.

14. Propaganda dhe lajme të rreme për vuajtjet e serbëve në Kosovë

Grups ekstremistë dhe organizata etno-nacionaliste serbe po përhapin lajme të rreme dhe propagandë për dhunën e pretenduar ndaj serbëve nga institucionet kosovare, duke ushqyer ndjenja të armiqësisë dhe tensioneve etnike.

15. Platformat dhe kanalet ekstreme në Telegram, si “Bunt,” “Бунт је стање духа” (Rebelimi është një gjendje shpirtërore), “СРПСКИ ГЛАСНИК” (Gazeta Serbe), “Српски вукови” (Ujqërit Serb), dhe të tjera, janë të angazhuara aktivisht në përhapjen e lajmeve të rreme dhe dezinformimeve që synojnë të demonizojnë institucionet e sigurisë në Kosovë, sidomos Policinë e Kosovës dhe KFOR-in. Këto platforma përdorin narrative që paraqesin Policinë e Kosovës si një forcë të dhunshme dhe të papërmbajtur ndaj serbëve të Kosovës, duke e akuzuar atë për “metoda represive” dhe “spastrim etnik” të serbëve në komunat veriore. Këto akuza janë të pavërteta dhe kanë qëllim të keqinformojnë, duke përshkruar pa bazë si të justifikuara veprimet e Policisë, e cila ka qenë e angazhuar për të mbrojtur rendin dhe ligjin, përballë grupeve të armatosura dhe bandave kriminale që veprojnë në këtë rajon. Përdorimi i termave të tilla si “spastrim etnik” ka për qëllim të shkaktojë frikë dhe të nxjerrë në pah një narrativë të rreme të viktimizimit të serbëve, e cila është shumë larg realitetit të situatës në terren.

16. Kanalet në fjalë shpërndajnë gjithashtu thirrje për dhunë, duke nxitur aksione kundër Policisë së Kosovës, KFOR-it, dhe objektivave shtetërorë të Kosovës. Përmes postimeve të rregullta, këto platforma promovojnë një atmosferë tensioni dhe urrejtjeje etnike, duke incituar pjesë të popullsisë për të kundërshtuar çdo përpjekje të shtetit të Kosovës për të ruajtur kontrollin dhe rendin në komunat veriore. Kjo përfshin nxitjen e akteve të dhunshme si reagim ndaj autoriteteve të Kosovës, duke e paraqitur si “rezistencë” të drejtë, përkundër faktit se shumë nga këto grupe janë të përfshira në aktivitete kriminale dhe terroriste.

17. Grupet ekstremiste fetare që operojnë në Telegram, si “Xhemati Alban ;Mburoja; përdorin këto platforma për të përhapur ideologjinë e ekstremizmit islamik dhe për të nxitur veprime terroriste. Ato shpërndajnë video dhe materiale propaganduese që përshkruajnë luftime të “xhihadistëve” kundër forcave të sigurisë në rajone të ndryshme si Izraeli, Gaza, Siria, Afganistani dhe Afrika e Veriut, duke përfshirë edhe veprime të dhunshme kundër shteteve të huaja. Këto grupe, gjithashtu, promovojnë nxitjen e urrejtjes ndaj Perëndimit dhe mbështetje për organizata terroriste si Al-Qaeda dhe ISIS.

18. Një taktikë e zakonshme e këtyre platformave është përdorimi i kanaleve tëdyfishta për komunikim. Kanali kryesor shpërndan materiale të dhunshme dhe mesazhe që nxisin rekrutimin e luftëtarëve për qëllime xhihadiste, ndërsa kanali rezerve siguron vazhdimësinë e komunikimit edhe në rast se kanali kryesor mbyllet nga autoritetet. Kjo strategji e përdorur nga këto grupe i lejon atyre të operojnë pa pengesa, duke u dhënë mundësinë për të vazhduar përhapjen e ideve ekstremiste dhe për të mobilizuar individë për aktivitete terroriste.

REKOMANDIME

Qeveria e Kosovës në koordinim të ngushtë me institucionet e sigurisë, duhet të bëjnë një vlerësim të kërcënimeve dhe rreziqeve që paraqet qasja e të rinjve në platformat e enkriptuara të komunikimit si telegram apo tiktok. Në rast se niveli i kërcënimit vlerësohet i lartë duhet të shikohen opsionet e kufizimit të qasjes së të rinjve në këto platforma të enkriptuara, sidomos Telegram dhe Tiktok. Qeveria e Kosovës duhet të konsideroj edhe ndalimin e plotë të platformave të Tiktok dhe Telegram në Kosovë, si një ndër rreziqet që po ndikon në përhapjen e dhunës, ekstremizmit dhe radikalizmit në vend.

Mediat nacionale si televizionet dhe portalet online, duhet të limitojnë promovimin e organizatave apo individëve të cilët promovojnë mesazhe dhe narrativa të cilët promovojnë gjuhë të urrejtjes, përçarje kombetare, fetare, gjinore apo atakojnë komunitete të cënueshme në Kosovë. Promovimi i individëve dhe organizatave të cilët në mënyrë të vazhdueshme po fyejnë praktikuesit religjioz mysliman në Kosovë, krijon mundësi për të përhapur elemente të formave të ndryshme të ekstremizmit dhe radikalizmit në vend;

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë MASHT), në bashkëpunim me Drejtoritë Komunale të Arsimit (DKA), duhet të adresojnë qartë dhe njëherë e përgjithmonë çështjen e bartjes së shamisë nga vajzat nën moshën 16 vjeçare gjatë procesit mësimor. Është e nevojshme të krijohet një kornizë ligjore dhe administrative që siguron trajtim të barabartë dhe shmang diskriminimin, duke parandaluar që drejtorët e shkollave ose stafi lokal të pengojnë arsimimin e vajzave për shkak të bartjes së shamisë. Menaxhimi jo i mirë i kësaj çështjeje ka krijuar hapësirë që organizatat terroriste dhe ekstremiste të manipulojnë situatën, duke e paraqitur Kosovën si një vend që kufizon të drejtat fetare, veçanërisht ndaj vajzave që praktikojnë Islamin. Organizatat terroriste po i përdorin këto narrativa për të promovuar ideologji radikalizuese dhe për të rekrutuar individë të rinj. Rregullimi i qartë dhe përfundimtar i problemit më bartjen e shamisë gjatë procesit mësimor, do të kufizonte ndjeshëm mundësinë e organizatave ekstremiste, si ISIS, për të përdorur këtë çështje si mjet propagande. Po ashtu, do të forconte mesazhin se Kosova garanton të drejtat bazike fetare dhe arsimimin e barabartë për të gjithë qytetarët e saj, duke mbyllur kështu hapësirat për ndikim radikal apo ekstremist në shoqëri. Ky hap është thelbësor për të promovuar tolerancën fetare, të drejtat e njeriut dhe integritetin e sistemit arsimor në vend.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë (MASHT) dhe Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), në bashkëpunim me mekanizmat lokal të arsimit, organizatat e shoqërisë civile (OSHC) dhe donatorët ndërkombëtarë, duhet të organizojnë kampanja të strukturuar vetëdijësuese dhe trajnime për mësuesit dhe nxënësit. Qëllimi kryesor është të informohen dhe pajisen ata me njohuri për rreziqet që vijnë nga materialet online që përmbajnë gjuhë urrejtjeje, mesazhe radikalizuese, ose përmbajtje që promovojnë ekstremizmin e dhunshëm. Për zbatimin e këtyre aktiviteteve, është thelbësore angazhimi i organizatave dhe kompanive me përvojë dhe ekspertizë të dëshmuar në trajtimin e tematikave të ndjeshme dhe komplekse. Kjo do të sigurojë që programet të jenë cilësore, të bazuara në praktikat më të mira ndërkombëtare dhe të përshtatura me nevojat lokale. Zbatimi i këtyre masave do të ndihmojë në ndërtimin e një kulture të sigurt dhe rezistente ndaj ekstremizmit dhe radikalizmit, duke fuqizuar njëkohësisht sistemin arsimor për të trajtuar kërcënimet e reja që paraqet përdorimi i internetit.

Një mundësi për të luftuar ekstremizmin online është të krijohen platformat dhe forumet online që promovojnë vlera pozitive, si toleranca, respekti dhe bashkëpunimi ndërkulturor. Këto mund të ofrojnë mundësi për rininë të angazhohet në diskutime dhe aktivitete që i ndihmojnë ata të zhvillojnë kritikizëm ndaj ideve ekstremiste.

Një aspekt kyç në luftën kundër ekstremizmit online është edukimi i të rinjve për përdorimin e sigurt dhe të përgjegjshëm të rrjeteve sociale, si dhe për aftësimin e tyre për të njohur dhe përballuar rreziqet që lidhen me manipulimin dhe radikalizimin. Për të arritur këtë, është e rëndësishme që të rinjve t'u ofrohen: Trajnime edukative të personalizuar, që u mësojnë atyre bazat e sigurisë digjitale, si ruajtja e privatësisë, mbrojtja nga kontaktet e dyshimta dhe rëndësia e raportimit të përmbajtjeve të papërshtatshme. Simulime praktike, ku ata të përfshihen në skenarë të krijuar posaçërisht për të demonstruar mënyrat se si manipulimi ndodh në platformat sociale. Këto simulime do t'i ndihmojnë të rinjtë të zhvillojnë një qasje kritike ndaj përmbajtjeve që hasin. Aktivitete interaktive dhe lojëra edukative, që synojnë t'i ndihmojnë ata të identifikojnë gjuhën e urrejtjes, propagandën dhe përmbajtjet radikalizuese. Trajnimet dhe aktivitetet duhet të jenë gjithëpërfshirëse dhe të zbatohet nga organizata që kanë ekspertizë në fushën e sigurisë digjitale dhe edukimit kundër ekstremizmit. Për më tepër, është thelbësore që prindërit, mësuesit dhe komunitetet lokale të përfshihen në këtë proces, për të krijuar një mbështetje të gjerë që forcon qëndrueshmërinë e të rinjve ndaj këtyre rreziqeve dhe kërcënimeve.

Gazetarët dhe profesionistët e medias luajnë një rol thelbësor në formësimin e opinioneve dhe perceptimeve publike. Për këtë arsye, është e rëndësishme që ata të kenë aftësi të avancuara për të identifikuar dhe përballuar dezinformatat dhe përmbajtjet me elemente radikalizuese që mund të përfshihen në lajme, artikuj apo materiale të tjera mediatik. Për të rritur këto aftësi, duhet të organizohen trajnime të specializuara që përfshijnë 1. Identifikimin e burimeve të dyshimta të informacionit, duke përfshirë lajmet e rreme, propagandën e maskuar si raportim të paanshëm dhe përmbajtjet që kanë për qëllim polarizimin ose manipulimin e audiencës. 2. Njohjen e gjuhës së urrejtjes dhe mesazheve radikalizuese, që shpesh përdoren për të polarizuar opinionin publik dhe për të promovuar narrativa ekstremiste dhe 3. Analizën kritike të përmbajtjeve dhe mesazheve, për të identifikuar taktikat e përdorura nga grupet radikale, si përdorimi i emocioneve për të krijuar përçarje ose për të rekrutuar individë të rinj. Këto trajnime duhet të mbështeten nga organizata të specializuara në mediat dhe komunikimin digjital, si dhe nga ekspertë të sigurisë dhe ligjit, për të siguruar një qasje gjithëpërfshirëse. Përmirësimi i kapaciteteve të gazetarëve dhe profesionistëve të medias në këtë fushë do të ndihmojë në reduktimin e ndikimit të dezinformatave dhe në pengimin e përhapjes së elementeve radikalizuese në shoqëri.

Ministria e Arsimit, në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB), me ndihmën e Drejtorive Komunale të Arsimit (DKA) dhe Këshillave të Prindërve në nivel lokal, duhet të përgatisin materiale edukative për ngritjen e kapaciteteve edukative të prindërve lidhur me monitorimin e qasjes dhe aktiviteteve të fëmijëve në platformat sociale të komunikimit. Kjo qasje do t'i mundësojë prindërve të monitorojnë aktivitetet e fëmijëve të tyre në mediat sociale dhe të parandalojnë që ata të bëhen viktimë të propagandës apo ekstremizmit online. Për këtë proces, duhet të krijohet gjithashtu një doracak ose manual i thjeshtë dhe i kuptueshëm për prindërit, i cili do t'u sigurojë udhëzime të qarta mbi mënyrën e monitorimit të sigurt dhe të efektshëm të aktivitetit të fëmijëve në internet. Ky doracak mund të përfshijë udhëzime për identifikimin e rreziqeve, si dhe këshilla për të biseduar me fëmijët në lidhje me kërcënimet e mundshme online dhe mënyrat e përballimit të tyre.

Ministria e Arsimit, në bashkëpunim me MPB dhe DKA, duhet të përgatisin një listë të platformave sociale që kanë potencial të dëmtojnë të rinjtë, për shkak të përmbajtjeve të dhunshme, radikalizuese, ose të dëmshme për shëndetin mendor dhe fizik të tyre. Kjo listë mund të përfshijë platforma të njohura si TikTok, Snapchat, Telegram, Instagram, Facebook, dhe YouTube, të cilat shpesh përdoren për përhapjen e mesazheve radikalizuese, gjuhës së urrejtjes, dhe përmbajtjeve që mund të ndikojnë negativisht në zhvillimin mendor dhe emocional të të rinjve. Për secilën nga këto platforma, duhet të hartohen udhëzime të qarta për mënyrat se si të rinjtë dhe prindërit mund të mbrohen, përfshirë: Përdorimi i cilësimeve të privatësisë për të kufizuar aksesin e personave të paautorizuar dhe për të kontrolluar që kush mund të shohë dhe komentojë përmbajtjet që postohen. Njoftimi dhe bllokimi i përdoruesve dhe grupeve që shpërndajnë përmbajtje radikalizuese ose të dhunshme. Përdorimi i mjetëve të monitorimit dhe filtrimit të përmbajtjes, si dhe aplikacioneve që mund të ndihmojnë në ndalimin e kontakteve të padëshiruara dhe mbrojtjen e fëmijëve nga mesazhet e dëmshme. Krijimi i një platforme raportimi për prindërit dhe të rinjtë, ku mund të denoncohen përmbajtjet e dhunshme, të paligjshme, ose të dëmshme, dhe të ndërmerren masa nga platformat e mediave sociale për largimin e tyre.



PREVENT

INSTITUTI PËR SIGURI DHE REZILIENCË